

**PKR.nr.191/16**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, në përbërje nga gjyqtarja Valbona Musliu-Selimaj, Kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarëve profesionist Faik Hoxha dhe Nora Bilaca-Dula, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nazife Sheholli, punëtores e kësaj gjykate, në çështjen penale, kundër të akuzuarve: **I. D.**, për shkak të veprave penale në bashkëkryerje, Kontrabandimi i mallrave nga neni 317 par.1 të KPRK-së lidhur me nenin 31 të KPRK-së, Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.1 të KPRK-së, **Xh. L.** dhe **L. H.**, për shkak të veprave penale në bashkëkryerje, Keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe Marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, **Sh. Xh.**, për shkak të veprave penale në bashkëkryerje, Kontrabandimi i mallrave nga neni 317 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.1 të KPRK-së dhe **A. S.**, për shkak të veprës penale, Ndihma nga neni 388 të KPRK-së për kryerjen e veprave penale, Kontrabandimi i mallrave nga neni 317 par.1 të KPRK-së dhe Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.1 të KPRK-së, të akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.82/2016, të datës 06.04.2016, pas mbajtjes së disa seancave të shqyrtimit gjyqësor, të hapura dhe verbale, të mbajtura me datat **20.04.2016, 23.05.2016, 20.09.2016, 24.11.2016**, dhe të vazhduar me datën **01.12.2016**, në prezencën e Prokurores së shtetit Dulina Hamiti, të akuzuarve **I. D.**, me mbrojtësin e tij sipas autorizimit, av.I. H., **Xh. L.**, me mbrojtësin e tij sipas autorizimit, av.O. L., **L. H.**, me mbrojtësin e tij sipas autorizimit, av.R. K., **A. S.**, me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av.Rr. G., dhe **Sh. Xh.**, me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av.B. J., Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës – Dogana e Kosovës, pas shqyrtimit në bazë të nenit 366 të KPPK-së, të nesërmen me datë **02.12.2016**, mori dhe publikisht në prezencën e palëve e shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **Të akuzuarit:**

**1. I. D.**, nga i ati D. dhe nënës S., e vajzërisë I., i lindur me *data e lindjes...* në fshatin D., Komuna e M., tani me vendbanim të përhershëm në S., ndërsa me vendbanim të përkohshëm në M. tek vëllezërit e tij në rrugën “.D.”, ka të kryer shkollën e mesme, drejtimi teknik i xehetarisë-minator i Trepçes, me profesion ekonomist, i martuar, baba i tre fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe të Suedisë, i cili ka qenë në masën e arrestit shtëpiak prej dt.02.03.2016 deri me dt.02.12.2016.

**2. XH. L.**, nga i ati C. dhe nënës B., e vajzërisë M., i lindur me *data e lindjes...* në fshatin P., Komuna e P., tani me vendbanim në F. K., Rr.”S. V.” Hyrja-./., nr., ka të kryer fakultetin e makinerisë, i punësuar në D. K., si udhëheqës i ndërrimit, grada., ndërsa në M. ka kryer punën e doganierit, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili ka qenë në masën e arrestit shtëpiak prej dt.02.03.2016 deri me dt.02.12.2016.

**3. L. H.**, nga i ati B. dhe nënës L., e vajzërisë K., i lindur me *data e lindjes...* në P., ku edhe jeton në lagjen B. D., Z. e lindjes rruga “H. T.”, -./., nr., student në Fakultetin Ekonomik, i punësuar në D. e

K., në pozitën e doganierit, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili ka qenë në masën e arrestit shtëpiak prej dt.09.03.2016 deri me dt.02.12.2016.

**4. SH. XH.**, nga i ati S. dhe nënës H., e vajzërisë M., i lindur me *data e lindjes...* në fshatin B., Komuna e M., me vendbanim të përhershëm në S., i martuar, baba i shtatë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme të elektros, i papunë, invalid, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, me shtetësi suedeze, në qytetin A., me adresë S.-. -... ..A., dhe me vendqëndrim të përkohshëm në Kosovë, në M., në rrugën-sheshi "A. H.", banesa e "R.-C.", afër Q. C., i cili ka qenë në masën e arrestit shtëpiak prej dt.09.03.2016 deri me dt.02.12.2016.

**5. A. S.**, nga i ati F. dhe nënës N., e vajzërisë J., i lindur me *data e lindjes...* në P., ku edhe jeton në rrugën "K. J.", pn., student i vitit të fundit në Fakultetin Ekonomik, i pa punë, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili ka qenë në masën e arrestit shtëpiak prej dt.09.03.2016 , e zëvendësuar me masën paraqitje në stacionin policor nga data 09.10.2016 në deri me dt.02.12.2016.

## I.

### JANË FAJTOR

#### I akuzuari I. D.:

##### Sepse:

**I.** Me datën 01.03.2016 rreth orës 10:01 në Pikën e Kalimit Kufitar-M., pas marrëveshjes paraprake e në bashkëkryerje nuk e ka deklaruar mallin të cilin e kishin të ngarkuar në furgonin "VW Caddy" me regjistrim *numri i targave...* të cilin e ka drejtuar i akuzuari I. D., ndërsa i akuzuari Q. B. me furgonin "Mercedes Vito 115", me regjistrim *numri i targave...*, si dhe i akuzuari Sh. Xh. me furgonin "Mercedes" me regjistrim *numri i targave...*, mallin të cilin e kishin ngarkuar e të cilin mall e kanë kontrabanduar duke e sjellur nga Suedia për në Kosovë, e që me të arritur në Pikëkalimin kufitar në M. me anë të dhënies së ryshfetit në shumë prej 650 euro të akuzuarve-zyrtarëve doganier L. H. dhe Xh. L., iu kanë shmangur kontrollit doganor, për mallin në vlerë prej 11,054.90 euro,-

- me këtë ka kryer veprën penale në bashkëkryerje me të akuzuarin Q. B. i cili gjendet në arrati, Kontrabandimi i mallrave nga neni 317 par.1 të KPRK-së lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

**II.** Me datën 01.03.2016 rreth orës 10:01 në Pikën e Kalimit Kufitar në M., me qëllim që mos të deklarojë mallin të cilin e kishin të ngarkuar në furgonin "VW Caddy" me regjistrim *numri i targave...*, për vlerën e mallit prej 1,311.50 euro, i njëjti i është shmangur pagesës së tarifave të detyrueshme doganore në vlerë prej 390.90 euro,-

- me këtë ka kryer veprën penale, Shmangia nga pagesa e tarifave doganore nga neni 318 par.1 të KPRK-së.

#### Të akuzuarit Xh. L. dhe L. H.:

##### Sepse:

Të akuzuarit Xh. L. dhe L. H. me datën 01.03.2016 rreth orës 10:01 në Pikën e Kalimit Kufitar në M. në garazhin e këtij pikë kalimi kufitar, në pozitën si zyrtar doganier, pas kontrollimit të tre furgonave

me mall të akuzuarve I. D., Q. B. dhe Sh. Xh., iu kanë mundësuar të njëjtëve që t'i kalojnë furgonat e ngarkuar me mall në vlerë prej 11,054.90 euro pa bërë pagesën e taksave të detyrueshme doganore,-

- me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata, në bazë të neneve të lartcekura dhe neneve 4; 7; 17; 21; 31; 41; 42; 43; 45; 62; 69; 73; 80 dhe 83 të KPRK-së dhe neneve 359; 360; 361; 365 dhe 366 të KPPK-së, të akuzuarit i:

## **G j y k o n:**

Të akuzuarit **I. D.**

- Për veprën penale në bashkëkryerje, Kontrabandimi i mallrave nga neni 317 par.1 të KPRK-së lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj,

- Për veprën penale në bashkëkryerje, Shmangia nga pagesa e tarifave doganore nga neni 318 par.1 të KPRK-së, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj,

Andaj gjykata i shqipton:

### **DËNIM UNIK ME BURGIM**

- Në kohëzgjatje prej **dhjetë (10) muajve**, në të cilin dënim dënim do të i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak dhe atë nga data 02.03.2016 deri me datën 02.12.2016, dhe

-Të akuzuarve **Xh. L.** dhe **L. H.**,

- Për veprën penale në bashkëkryerje, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, secilit veç e veç, dënim me burgim në kohëzgjatje prej **dhjetë (10) muajve**, në të cilin dënim dënim do të i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak dhe atë nga data 02.03.2016 deri me datën 02.12.2016, dhe

### **DËNIM PLOTËSUES**

- Konfiskohen: furgoni “VW Caddy” ngjyrë e bardhë, me regjistrim *numri i targave...*, nga i akuzuari I. D., furgoni “Mercedez Benz” 115 CDI ngjyrë e kuqe, me regjistrim *numri i targave...*, të cilin e ka drejtuar i akuzuari Q. B., furgoni “Mercedes” ngjyrë e bardhë me regjistrim *numri i targave...*, të cilin e ka drejtuar i akuzuari Sh. Xh., mjete këto që janë përdorur në kryerjen e veprave penale.

- Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguajnë shpenzimet aq sa do të llogariten sipas shpenzimeve të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç shumën prej pesëdhjetë euro (50€), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara, Dogana e Kosovës për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

**Në bazë të nenit 364, par. 1 nënpar. 1.3 të KPP të Republikës së Kosovës;**

## **II.**

### **LIROHEN NGA AKUZA**

### **Të akuzuarit I. D. dhe Sh. Xh.**

#### **Sepse:**

**I.** Me datën 01.03.2016 rreth orës 10:01 në pikën e kalimit kufitar në M., me qëllim që mos ta deklarojnë mallin të cilin e kishin të ngarkuar në furgonin VW Saddy me regjistrim *numri i targave...* të cilin e ka drejtuar i akuzuari i lartcekur I. D., si dhe të akuzuarit Q. B. me furgonin Mercedes Vito 115, me regjistrim *numri i targave...* dhe i akuzuari Sh. Xh. me furgonin Mercedes me regjistrim *numri i targave...*, e që me të arritur në pikën e kalimit kufitar në M., i akuzuari I. D. iu ka dhënë ryshfet në shumë prej 650 euro të akuzuarve-zyrtarëve doganier L. H. dhe Xh. L., për t'iu shmangur kontrollit doganor, për mallin në vlerë prej 11,054.90 euro,-

- sepse nuk është provuar se të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

### **Të akuzuarit Xh. L. dhe L. H.**

**II.** Të akuzuarit Xh. L. dhe L. H. me datën 01.03.2016 në pozitën si Zyrtar Doganor në Pikën e Kalimit Kufitar në M., në garazhin e këtij pikë kalimi kufitar, pas kontrollimit të 3 furgonave me mall të të akuzuarve I. D., Q. B. dhe Sh. Xh., iu ka mundësuar të njëjtëve që t'i kalojnë furgonat e ngarkuar me mall pa e bërë pagesën obligative doganore, në atë mënyrë që të akuzuarit Xh. L. dhe L. H. kanë marrë ryshfet prej të akuzuarit I. D. shumën në vlerë prej 650 euro, e që pastaj këto para të akuzuarit Xh. L. dhe L. H. i kanë ndarë në mes vete në mënyrë të barabartë nga 325 euro,-

- sepse nuk është provuar se të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, Marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

### **I akuzuari Sh. Xh.**

**III.** Me datën 01.03.2016 rreth orës 10:01 në Pikën e Kalimit Kufitar në M., me qëllim që mos ta deklarojë mallin të cilin e kishin të ngarkuar në furgonin Mercedes me regjistrim *numri i targave...*, për vlerën e mallit prej 5,929.00 euro, i njëjti i është shmangur pagesës së tarifave të detyrueshme doganore në vlerë prej 1,790.44 euro,-

- sepse nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale, Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.1 të KPRK-së.

### **I akuzuari A. S.**

**IV.** I akuzuari A. S. me datën 01.03.2016 në Pikën e Kalimit Kufitar në M. i ka ndihmuar të akuzuarit I. D., Q. B. dhe Sh. Xh., ashtu që pas kalimi të Pikë Kalimit Kufitar nga Serbia në Kosovë, mallin që e kanë pasur nëpër furgona iu ka ndihmuar që ta shpërndajnë, ashtu që i akuzuari A. S. shkon para furgonave në distancë prej disa kilometrave dhe siguron nëse ka kontrolla policore apo doganore dhe nëse ka kontrolla A. i lajmëron me telefon të akuzuarit I. D. dhe të akuzuarit tjerë të lartcekur, ashtu që i njëjti një pjesë të mallit duke e marrë prej të akuzuarit I. D. dhe e ka ngarkuar në furgonin e tipit "Mercedez Benz" 316 CDI, ngjyrë hiri me regjistrim *numri i targave...*,-

- sepse nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale, Ndhurma nga neni 388 të KPRK-së për kryerjen e veprave penale, Kontrabandimi i mallrave nga neni 317 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale, Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.1 të KPRK-së.

- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

- Të akuzuarit A. S. i kthehet furgoni "Mercedez Benz" 316 CDI, ngjyrë hiri, me regjistrim *numri i targave...*, ndërsa të gjitha gjësendet e sekuestruara me Aktvendimin e Gjyqtarit të Procedurës Paraprake të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të rënda PPRKR.nr.82/16 të datës 04.03.2016 konfiskohen.

Me aktvendim të veçantë PKR.nr.191/16 të datës 02.12.2016, gjykata konform nenit 367 par.1 pika 1.2 të KPPRK-së, të akuzuarve I. D., Xh. L., L. H. dhe Sh. Xh. iu ka ndërprerë masën e arrestit shtëpiak, si dhe të akuzuarit A. S. ia ka ndërprerë masën paraqitje në stacionin policor.

Gjykata me aktvendimin PKR.nr.191/16, të datës 21.04.2016 ndaj të akuzuarit Q. B. ka veçuar procedurën penale, pasi që i njëjti gjendet ne arrati.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/L.nr.82/2016, të datës 06.04.2016, kundër të akuzuarve: I. D., për shkak të veprave penale në bashkëkryerje, Kontrabandimi i mallit nga neni 317 par.1 të KPRK-së lidhur me nenin 31 të KPRK-së, Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe Shmangia nga pagesat e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.1 të KPRK-së, Xh. L. dhe L. H., për shkak të veprave penale në bashkëkryerje, Keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe Marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, Sh. Xh., për shkak të veprave penale në bashkëkryerje, Kontrabandim i mallit nga neni 317 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së she Shmangia nga pagesat e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.1 të KPRK-së, Q. B., për shkak të veprës penale, Shmangia nga pagesat e tarifave të detyrueshme nga neni 318 par.1 të KPRK-së dhe A. S., për shkak të veprave penale, Ndhima nga neni 388 të KPRK-së për kryerjen e veprave penale, Kontrabandim i mallit nga neni 317 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale, Shmangia nga pagesat e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, e për të akuzuarin Q. B. me Aktvendimin e datës 21.04.2016, ka Veçuar procedurën kundër tij, ndësa vazhdoi me procedurën kundër të akuzuarve të tjerë, ku menjëherë pas leximit të aktakuzës nga prokuroja e shtetit, të akuzuarve iu dha mundësia e deklaramit të tyre lidhur me akuzën e cila u vihet në barrë dhe të njëjtit nuk e pranuan fajësinë për veprat penale, u deklaruan të pafajshëm andaj gjykata vazhdoi me procedimin e çështjës dhe me mbajtjen e disa seancave të shqyrtimit gjyqësor me administrimin e provave materiale, me fjalën hyrëse, administrimin e provave materiale me mbrojtën e të akuzuarve si dhe me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurorja e shtetit në fjalën e saj përfundimtare deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës, ngase nga administrimi i provave në mënyrë të pa dyshimtë dhe të plotë, u vërtetua se të akuzuarit I. D., Sh. Xh., Xh. L., L. H. dhe A. S. kanë kryer veprat penale si në aktakuzë, u vërtetua se të akuzuarit nga Suedia kanë kontrabanduar mallin të cilin e kanë sjellur në Kosovë, duke kaluar në pikën e kalimit kufitar në M., me anë të dhënies së ryshfetit L. H.t dhe Xh. L.t dhe atë shumë prej 650 eurove, e që këtë shumë të parave të akuzuarit e kanë ndarë mes vete, këtë fakt e ka deklaruar edhe vet i akuzuari L. H. në deklaratën e dhënë në polici, ku në tërësi ka pranuar veprimet e tij duke deklaruar se pikërisht në zyren e pikës në M., ka pranuar nga I. D. shumë prej 650 euro, të cilat i kishte nxjerrë nga xhepi i tij dhe ua kishte dhënë të akuzuarve Xh. dhe L., të cilat i kanë ndarë në mes tyre nga 325 euro, të cilët duke qenë në cilësinë e personave zyrtar, oficer doganor, iu kanë mundësuar të akuzuarve

I. D., Q. B. dhe Sh. Xh., që të kalojnë me furgon-kombi nëpër pikën kufitare pa i paguar obligimet doganore, duke i vendosur këta furgona në garazhen e pikës së kalimit kufitar, dhe pastaj pa i kontrolluar tërësisht dhe pa i'u lëshuar asnjë dokument i lirojnë nga dogana, e kjo u vërtetua edhe nga transkriptet e bisedave në mes të akuzuarve L. H. dhe I. D., pikërisht në ditën kritike dt.01.03.2016 ku i kishin kordinuar veprimet e tyre në momentin e arritjes së të akuzuarve I. D., Sh. Xh. dhe Q. B., në pikën kufitare dhe pasi e kalojnë pikën e kalimit në M., L. e lajmëron I. duke i thënë se ka kontrollë në Lluzhan, ku pastaj këto automjete pasi kalojnë pikën e kalimit kufitar dhe i akuzuari A. S. del i pret me automjetin e tij duke i ndihmuar të akuzuarit që të bëjnë kontrabandimin e mallit dhe shmangien nga pagesa, ku pastaj dhe janë ndaluar nga hetuesia e doganës, këto vepra

penale të akuzuarit i kanë kryer me dashje, i akuzuari Xh. L., në mbrojtjen e tij të dhënë pranë trupit gjykues deklaroi se tërë furgonat me mallë i kanë liruar vetëm me urdhër gojor, pa e bërë kontrollimin e tërësishëm të mallit të furgonit në pikë-kalimin kufitar, sa i përket të akuzuarve I. D. dhe Sh. Xh., nuk është kontestuese, se në bashkëkryerje me të akuzuarin Q. B. i cili gjendet në arrati, kanë kontrabanduar mallin e sjellur nga Suedia në Kosovë, duke kaluar në pikën e kalimit kufitar, me ç'rast iu kanë shmangur tarifave doganore, i akuzuari A. S. ka ndihmuar në kryerjen e veprës penale dhe atë pas kalimit kufitar të akuzuarit I. D. dhe Sh. Xh., andaj i propozoj gjykatës që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit dhe malli dhe veturat që janë përdorë si mjete për kryerjen e veprës penale për kontrabandim të mallit, të konfiskohen.

Përfaqësuesi i palës së demtuar-Dogana e Kosovës, të cilën e ka përfaqësuar Ministria e Drejtësisë, ka deklaruar me parashtresë se parashtrohet kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit I. D. av. I. H. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e kundëshkon në tërësi aktakuzën, si të pabazë, nga se nuk u vërtetuar me asnjë provë bindëse se i mbrojturi i tij, I. D. ka kryer veprat penale për të cilat aktakuza e ngarkon, aktakuza është e përshkruar apo e marrë blanko nga kallëzimi penal i policisë dhe nuk është analizuar se a ka prova që vërtetojnë gjendjen faktike, e kjo për faktin se i mbrojturi i tij me grupin që ka ardhur nga Suedia, që akuzohen për vepra penale, kontrabandimi i mallrave, dhënie ryshfeti dhe shmangie nga tatimi, me bindje të thellë konsideroj se asnjëra nga këto nuk kanë bazë të fortë që e vërtetojnë gjendjen faktike dhe se nuk përkojnë me realitetin, e që realiteti është krejt ndryshe, I. D. me rastin e ardhjes nga shteti i Suedisë, ditën kritike ka hyrë në terminalin doganor të shtetit të Kosovës, në mënyrë krejtësisht të rregullt-legale, duke iu nënshtruar urdhërit të policisë doganore, më pastaj me dokumentacion legal, te personeli doganor, ashtu që qëllimi i tij nuk ka qenë t'i shmanget tarifës doganore apo kontrabandimi i ndonjë malli duke i mashtruar doganerët me nga 325 euro, për t'u dhënë ryshfet, këtë e vërtetuan edhe dy doganierët se mënyra e futjes në kufi të I. D. ishte në rregull, me kontrollat e tyre se ka të bëjë mall apo sende që janë dërguar nga bashkëatdhetarët për familjet skamnore në Kosovë. Andaj, bazuar në të gjitha këto, i propozoj gjykatës që t'i analizon deklaratat e secilit veç e veç, ashtu që pas administrimit të provave në tërësi të nxjerrë aktgjykim lirues.

I akuzuari I. D. në mbrojtjen e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se ditën kritike kishte ardhur nga Suedia për në Kosovë, dy vetura ishin të një personi me emrin S. Sh. nga L., njëra Mercedes Vito dhe një Pikap, me regjistrim suedez, por kishte të drejtë dhe autorizim për t'i sjellë në Kosovë, ndërsa vetura e tipit Mercedes Spriter ishte pronë e tij, në të cilën ka pasur rroba të punës, një shtrat i fjetjes me jogi dhe gjësende tjera e me të arritur në doganë fillimisht ka bërë edhe pagesën e sigurimit dhe atë për të tre kombat, pasi kishte autorizimin për to, pastaj doganieret i kanë futur në një garazh që ishte në doganë dhe kanë hapur kombin, kanë parë gjësendet e përdorura, të vjetra që u kishte treguar që janë ndihma humanitare për familjet skamnore në Kosovë dhe i kishin liruar nga dogana. Askujt nuk i kishte dhënë ryshfet, përveq pagesës së sigurimit dhe deklaroi se është plotësisht i pafajshëm, ndërsa në P. kishte dalë personi A., ngase axha i tij ia kishte dërguar disa teshat dhe një shtrat me një dyshek për t'i marrë. Personat Sh.

Xh. dhe Q. B., kishin udhëtuar së bashku nga Suedia për në Kosovë dhe të njëjtit i kishte kojshi në Suedi ku edhe jetonte, Sh. Xh. e kishte marrë në përgjegjësi deri në Kosovë ngase ai nuk kishte të drejtë me u nisë vet pasi ishte i sëmurë, dhe atë vetëm në cilësinë e bashkudhëtarit, i cili me vete kishte vetëm një qante dore me barna dhe asgjë tjetër dhe ia kishte vozitur kombin pak para kufirit pasi që deri në kufi e kishte drejtuar një person me emrin F., i cili para kufirit dikun në largësi prej 500-1000 metra kishte dal nga vetura e tij për të shkuar me autobus dhe e kishte vozit Sh.. Pasi i kishin përfunduar të gjitha procedurat doganore për kombin e tij, kishte ndaluar për ti prituri edhe dy veturat e tjera që ishin mbrapa tij, të cilat i kishin futur në garazhen ku bëhej kontrollimi i mallit dhe të triat ishin kontrolluar në atë vend, nga dy doganierët Xh. dhe L. dhe u kishte treguar doganierëve se është mall që e kanë dorëzuar mërgimtarët, e pasi kishte bërë pagesën e sigurimit, kishin dalën prej aty dhe i kishin dërguar veturat në servis për shkak të defekteve që i kishin. Me të arritur në P. i ka ndaluar policia e Doganës, i ka marrë të tre kombit me gjithë mallin, i ka pyetur a kanë leje nga

dogana. Në fund deklaroi që nuk ndihet fajtor për veprat penale që i vihen në barrë sipas aktakuzës, se kishte sjell mall nga Suedia nga mërgimtarët, nuk i ishte kërkuar që të paguaj dogan por ka paguar vetëm sigurimin në mënyre legale.

Mbrojtësi i të akuzuarit Xh. L., av.O. L. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e kundërshton në tërësi aktakuzën e prokurorisë, sa i përket veprës penale në bashkëkryerje, marrja e ryshfetit, nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i akuzuari Xh. e ka kryer këtë vepër penale. Një deklaratë e një të akuzuari në procedurë hetimore e që është edhe i akuzuar e cila deklaratë bazuar në nenin 262 të KPP-së, që i përket provave lidhur me përcaktimin e fajësisë, gjykata nuk mund ta shpall fajtor të akuzuarin duke u mbështetur në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një deklarami të dhënë nga një i akuzuar në Polici

Doganore e që të njëjtën deklaratë më vonë e mohon. Asnjëri nga të akuzuarit nuk deklaruan se Xh. L.. ka kërkuar e as që i ka dhënë dikush ryshfet, me asnjërin prej të akuzuarve nuk ka pasur lidhje e as telefonata, as që i ka njohur më parë. Gjatë zhvillimit të procedurës nuk është vërtetuar me asnjë provë se i mbrojturi i tij ka marrë ryshfet nga ndonjëri prej të bashkëakuzuarve prandaj kërkoj që të shpallet i pafajshëm lidhur me veprën penale marrja e ryshfetit. Sa i përket veprës penale keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar, e kundërshtoj sepse nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar se i akuzuari Xh. L. ka kryer këtë vepër penale, për faktin se nuk është se çdo keqpërdorim të jetë patjetër vepër penale. Në raste të caktuara mund të ketë karakter të përgjegjësisë disiplinore ose të ndonjë përgjegjësie tjetër.” Në rastin konkret kemi të bëjmë me një përgjegjësi disiplinore, e që i akuzuari Xh. L. për këtë keqpërdorim është përgjigjur para Komisionit Disiplinor në Doganën e Kosovës, kjo vepër penale kryhet me dashje të drejtpërdrejt e cila përfshin dijenin e kryesit se po e shfrytëzon pozitën e tij zyrtare, po i tejkalon kompetencat e tij ose nuk po e kryen detyrën e tij si dhe faktin se me këtë ai përfiton dobi pasurore për vete apo për tjetrin ose i shkakton tjetrit çfarëdo dëmi”. Në rastin konkret i mbrojturi i tij nuk ka pasur kurrfarë lidhje me të akuzuarit të tjerë. Prandaj bazuar në këto prova dhe fakte i propozoj gjykatës që kjo aktakuzë të hudhet poshtë, e i akuzuari Xh. L. të shpallet i pafajshëm.

I akuzuari Xh. L. në mbrojtjen e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se me dt.01.03.2016 ka qenë në punë në pikë-kalimin kufitar në M., ku Dogana e Kosovës punon me tri burime informative: në bazë të informatave nga sektorët e brendshëm që lajmrojnë me shkresa të ndryshme për mundësinë e futjes së mallrave në Kosovë, sistemin elektronik me anë të të cilit bëhet shkëmbimi informatave të mallrave komerciale që kalojnë tranzit në Serbi dhe anasjelltas dhe nëpër pikë kalime të ndryshme kufitare kanë lista me emra të njerzëve të cilët duhet ti kontrollojnë më shumë për shkak të aktivitetit të lëvizjes së tyre. Në ditën kritike ishin paraqitur në doganë 3 furgona, makina e parë pikap furgon më i vogël dhe në kontrollin doganor në orën 08:37 min, kontrollin e këtij e kishte përfunduar kolegu L. H. kurse pas përfundimit të kontrollit kishte shkuar në zyre L. dhe e kishte njoftuar për kontrollin që ua ka bërë mallrave dhe që i ka liruar, rreth orës

09:11 kishte shkaur vetura Mercedes Sprinter furgon e drejtuar nga Sh. Xh. në garazhën e kontrollit ku e kanë bërë kontrollin, e kanë pyetur Sh. a ka diçka për ta deklaruar për doganë, i cili u është përgjigjur se nuk është furgoni i tij dhe tani i vjen personi përgjegjës, kur edhe kishte shkuar I. me fletën e sigurimit kufitar në dorë, i cili u ka treguar se ka mall të vjetër, që i kanë dërguar familjeve në Kosovë, ka hapur furgonin I., dhe kishin parë dy dyshek të përdorur, një krevet anash i mbështjellur në letra i përdorur dhe pas dyshkut 4 - 5 qanta me emra të ndryshme, secila qantë ka pasur emër, mbiemër, një qantë e ka hap ka parë tesha të përdorura, me një aromë të rrobave të përdorura, e pasi ka parë këtë mall ka kërkuar ta mbyll furgonin dhe e kanë liruar, e po ashtu nuk kanë pasur asnjë informatë nga sektorët e brendshëm për mundësinë e futjes së ndonjë malli të pa lajmëruar duke i krahasuar të dy informatat si dhe bisedës a kishin mall për ta lajmëru në doganë, por meqë malli ishte i përdorur, ka treguar një rrezik të ulët i kanë liruar nga detyrimet doganore dhe nga kontrollet detajore doganore, e njësoj kishte vepruar edhe tek dy furgonat e tjerë, ku të tretin e ka drejtuar një shofer tjetër që ka qenë edhe ai i akuzuar B. dhe një shtetas suedez dhe momentin që e ka drejtuar për në garazh e ka pyetur a ka diçka me deklaruar për doganë por i është përgjigjur se nuk

është përgjegjës i mallit, aty kishte shkaur I. me dokumentet e sigurimit, i cili ka deklaruar njësoj se ka sjell ndihma për familje të varfëra në Kosovë dhe kishte vepruar njësoj si me furgonin me herët i ka liruar nga kontrolli doganor. Nuk i ka ofruar askush ryshfet dhe në prezencën e tij nuk ka parë as që ka dhënë ndokush e as që ka marrë, ishte e vërtetë që e ka bërë kontrollimin e pjesërishëm të të dy furgonave e jo tërë mallit por vetëm një pjesë të tij, jo në detaje, jo të gjitha qantat, por në secilin furgon nga një qantë, secila qantë ka pasur emra, e pas kontrollit në garazhë si dhe nga njoftimet dhe indikacionet që kishin paraprakisht e që nuk u kanë dhënë inidikacion për kontrollë të tërësishëm, i kanë liruar duke i njoftuar vetëm në formë gojore se janë të lirë, edhe pse ekzistojnë formularet për persona që lirohen nga doganimi i mallit nuk u janë lëshuar leja në formë të shkruar as fizike as elektronike. Të gjitha mallrat që nuk janë komerciale nuk zhdoganohen, malli komercial nënkupon mallin për shitje, ndërsa malli të cilin e ka parë ka qenë malli i përdorur dhe nuk ka qenë për shitje por mall i familjeve per Kosovë. Të gjitha veprimet e tija i ka mbështetur komplet në suaza ligjore, dhe kërkoi nga gjykata të shpallet i pafajshëm.

Mbrojtësi i të akuzuarit L. H. av.I. M. me autorizim zavendësues nga mbrojtësi R. K., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e kundërshton aktakuzën si të pa bazuar dhe prokuroria ka potencuar shumë çështjen e një mosplotësimi të një formulari joobligativ, nga shkresat e lëndës rezulton se L. H. më dt.09.03.2016, në ora 13:15, ka qenë njëkohësisht në dy vende të ndryshme, duke u marrë në pyetje në procedurën paraprake, jo hetimore, si i dyshuar te zyrtari doganor L. Gj. ku është mbrojtur në heshtje dhe deri në ora 13:20, kurse nga zyrtari policor M. S. në të njejtën minutë nga procesverbalet tjera është arrestuar dhe ndaluar kinse duke iu njoftuar për të drejtat e tij gjatë arrestimit e pa nënshkrim të tij, koha e kryerjes së veprës penale kur prokuroria pretendon se të bashkëakuzuarit I. D. e të tjerët me dt.01.03.2016 i kanë dhënë ryshfet L. dhe Xh., nga shkresat e lëndës në po këtë të njejtën kohë nga përgjimet e fshehta 01.03.2016, në bazë të këtij transkripti rezulton se në të njejtën sekondë që L. me I. paskan biseduar me telefon me kilometra larg, si ka mundur me u dhënë ryshfeti nga kjo distancë, në fjalën përfundimtare Prokuroria e Shtetit e quan deklaratë, gjë që nuk qëndron te L. mbi pranimin e fajësisë, nga procesi shifet se ajo është një rrëfim, institucion i panjohur në procedurë penale ku ai rrëfimin e jep si i dyshuar te hetuesi doganor. Mallrat që propozohen si provë nga prokuroria, njëkohësisht konfiskimin e mallrave të konstatuara në këto procese nuk janë procese mbi sekuestrim në pajtim me dispozitat e KPPK-së, ato thjesht janë mallra të ndalura sipas Kodit Doganor, në procedurë administrative eventualisht mund të zhvillohet ndonjë konflikt administrativ dhe nuk mund të jenë prova në procedurë penale. Provat vërtetojnë se këta as nuk janë kontrabandistë, procedura e kontrollit, lirimimit të mallrave është bërë në pajtim me ligjin dhe se nuk ka asnjë provë të drejtpërdrejtë as e tërthorët për vërtetimin e marrjes së ryshfetit, ska as dëshmitar as fotografi as një provë tjetër të prekshme, andaj bazuar në vendimin në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor sepse mbrotja mendon se nuk ka pas hetime dhe nuk ka mundur të ngritet aktakuza, i propozoj gjykaës që të marrë aktgjykim lirues.

I akuzuari L. H. e shfytëzoi të drejtën e tij ligjore për tu mbrojtur ne heshtje gjatë shqyrtimit gjyqësor, ndërsa në deklaratën e tij të dhënë gjatë hetuesisë i njëjti e ka pranuar se I. D. në ditën kritike i kishte dhënë ryshfet ne shumë prej 650 € të cilat i kishte nxjerrë nga xhepi dhe ua kishte lënë në tavolinë të njëjtat i kishin ndarë me Xh., përgjysmë dhe të tre furgonët vetëm pjesërisht i kishin kontrolluar dhe i kishin liruar pa doganë, ishte penduar shumë, për veprimet e tija, ndërsa në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e përkrahë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh. Xh., av.B. J. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se edhe pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave, mbrojtja e të akuzuarit Sh. Xh., në tërësi e kundërshton aktakuzën si të pabazuar nga se për gjatë shqyrtimit gjyqësor pa mëdyshje u vërtetua se në veprimet e të akuzuarit Sh. Xh., nuk manifestohet asnjë element qenësor i veprave penale për të cilat Prokuroria e Shtetit në Prishtinë ka ngritur aktakuzë. Se i mbrojturi i tij nuk ka kryer vepër penale kjo u vërtetua fillimisht nga mbrojtja e të akuzuarit I. D. i cili deklaroi se të akuzuarin Sh. Xh. e ka marrë nga Suedia për në Kosovë, vetëm si bashkëudhëtar e natyrisht me kërkesën e të akuzuarit Sh. po ashtu pafajësia e të mbrojturit tim shihet qartë dhe në mënyrë bindëse u vërtetua edhe nga deklaratat e të akuzuarve të tjerë të cilët me asnjë rrethanë nuk japin asnjë



element sa më të vogël që do të kishte mbështetur një dyshim se i mbrojturi i tij të ketë kryer veprat penale. Prandaj konsideroj se prokuroria me asnjë provë të vetme nuk ka arritur që të vërtetojë dyshimin e bazuar, por edhe në këtë fazë të procedurës pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor çështja mbetet vetëm në dyshim dhe pa u vërtetua me asnjë provë të vetme, prandaj gjykatës i propozoj se të mbrojturine tij ta liroj nga akuza në mungesë të provave, të marrë aktgjykim lirues.

I akuzuari Sh. Xh. në mbrojtjen e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se ishte nisur nga Suedia për në Kosovë së bashku me I., me veturën e tipit Mercedes kombi, ngjyrë e bardhë, për ta vizituar nënën e semurë, dhe vazhdimisht kishte qenë me I. dhe një shofer tjetër që e ndërronte I. në vozitje, emrin nuk ia dinte, edhe pse ka paten shofer të Suedisë, nuk ishte në gjendje të vozis ngase që 5 - 6 vite ishte në gjendje tejet të rëndë shëndetësore. Para se të hyjnë në kufirin e Kosovës, personi i cili ishte me ta ka pasur frikë me kalu kufirin dhe para kufirit e kishte zbitur dhe e kishte marrë me vozit deri në garazhën e doganës atë kombi i cili ishte automatikë, dhe e ka kaluar kufirin, ndërsa I. ka shkuar të paguaj kufirin. Në doganë e kanë pyetur se çfarë malli ka në kombi, ishte përgjigjur se nuk dinte, I. ka folur me doganiera por nuk e dinte se çka kanë folur, skishte parë asgjë. Nuk e dinte se me çka është marrë I., por se ka pas një agjencion të autobusave edhe para disa viteve ka vozitur autobus të udhëtarëve, të njëjtin e njëjste qysh kur kanë qenë minator, nuk e njeh per sende të këqija, nuk e kishte parë nëse I. ka folur me dikë në telefon gjatë rrugës. U deklarua i pafajshëm, malli nuk ishte i tij, ka pasur me vete vetëm ilaqet e tija personale për shkak të shëndetit të ligë dhe asgjë tjetër, asnjë mall nuk ka qenë i tij dhe asnjëherë në jetën e tij deri tani nuk është marrë më asgjë të kundërligjshme.

Mbrojtësi i të akzuarit A. S., av.Rr. G. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e kundërshton në tërësi aktakuzën e prokurorisë, ndërsa e përkrah deklaratën e të mbrojturit të tij se nuk është fajtori i verpës penale, duke konsideruar se nga provat e administruara nga i mbrojturi i tij dhe të akzuarit e tjerë në procedurë, nuk u vërtetua teza e akuzës se A. S. ka kryer veprat penale si në aktakuzë. Përshkrimi në aktakuzë që paraqitet nga prokuroria nuk mbështetet në provat e administruara, por përshkrimi është i bazuar kryekëput në supozime. Në aktakuzë thuhet se A. S. ka kryer vepër penale, Kontrabandimi i mallit, e vërteta qëndron krejt ndryshe, të mbrojturit të tij mallin nga Suedia i'a ka dërguar axha i tij, i cili punon në Suedi, nëpërmes I. D.t, me të cilin ka raporte miqësore. A. nëpërmes I. ka marrë një mall të vjetër, të përdorur në vlerë prej 88.00 euro, ndërsa shmangiet nga tatimi doganor në vlerë prej 26.22 euro, sipas deklaratës së I. D.t, A. nuk ka qenë i informuar për pagesën e doganës, e as që ka ditur për të. Ky mall

i përdorur me këtë vlerë simbolike ka qenë i dedikuar vetëm për nevojat familjare të A.. Konsideroj se prokuroria ka dështuar kur e ka kualifikuar mallin si kontrabandim, duke u bazuar në këtë vlerë-shumë simbolike dhe duke pasur parasysh se i mbrojturi i tij nuk e ka sjell mallin nga Suedia dhe natyrisht nuk ka qenë i obliguar t'i nënshtrohej obligimeve doganore, kështu që prokuroria ka dështuar në dy cilësimet e saja, kontrabandim dhe shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore, pra pagesën e doganës e bënë personi që e sjell mallin, ndërsa pas kësaj për kompenzim të vlerës së doganës duhet të merren vesh që të dyja palët. Në fund i propozoj gjykatës që në harmoni me dispozitat e KPP-së të marr aktgjykim lirues, sepse për veprat penale për të cilat akuzohet A. S, nuk është provuar se i ka kryer.

I akuzuari A. S. në mbrojtjen e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se është ekonomist i diplomuar, i pa punë, jetoj me gruan, dy fëmijet, prindërit dhe gjyshen, punon punë krahu sipas nevojës, kur gjen punë, në shitore të vjetra blen rroba më të lira i shet në treg. Me I. D.n ka raporte miqësore, axha i tij i kishte dërguar mall nga Suedia dy deri në tri herë, atë mall e ka përdorur për nevoja personale sepse ato kanë qenë rrobat e trupit për të dhe familjen, të cilat ua ka dërguar në Kosovë. Në ditën kritike e ka thirrë I. në telefon, diku paradite, që të del t'i marrë rrobat që ia ka sjellë prej Suedisë, pasi që e ka veturën në defekt i kishte kërkuar që të shkoj në P. ti marr dhe aty ishin takuar larg pikës doganore, në parkingun e qendres tregtare "A." në P., e kishte takuar I. me kombin e vet dhe e ka marrë mallin dhe e ka futur në kombin e tij, edhe dy kombi tjetër ishin të

automekaniku. Në momentin që e kishte marrë qantën nuk e ka hapur, e qantë është hapur vetëm në doganë, në të cilën ka pasur veshëmbathje të ndryshme, ku ka pas të shkruar emrin e tij. Nuk e kuptoi se si mund të akuzohet për shmangien nga pagesa doganore kur nuk ka kaluar doganë, nuk ka kyer asnjë vepër penale siç ngarkohet në aktakuzë, nuk iu ka ndihmuar të akuzuarve tjerë për të ngarkuar dhe shkarkuar mallin por vetëm ka shkruar te I. që ta marrë mallin e tij që ia ka dërguar axha nga Suedia. Atë ditë përveç I. e ka takuar edhe një person që dukej shumë i lodhur, i ulur në një skaj, e kur ka filluar ky proces gjyqësor, e ka kuptuar se ai është Sh. Xh..

**Gjykata administroi edhe provat materiale siç janë:** 1).Aneksi me nr. *numri...* i dt. 01.03.16 për sekuestrimin e sendeve nga i akuzuari I. D., 2).Aneksi me nr. *numri...* i dt. 01.03.16 për sekuestrimin e sendeve nga i akuzuari I. D., 3).Aneksi me nr. *numri...* i dt.01.03.16 për sekuestrimin e sendeve nga i akuzuari A. S., 4).Aneksi me nr. *numri...* i dt. 01.03.16 për sekuestrimin e sendeve nga i akuzuari Sh. Xh., 5).Aneksi me nr. *numri...* i dt. 01.03.16 për sekuestrimin e sendeve nga i akuzuari Sh. Xh., 6). Bisedat e transkriptove në mes të akuzuarve, 7).Raporti i Ekspertimit dt.06.04.2016 nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, 8).Raporti final i dt. 24.03.2016 nga polici hetues M. S. së bashku me foto dokumentacionet si dhe shikimi i CD-së me video incizim në pikën e kalimit kufitar ku ka ndodh rasti në M..

Rrjedhimisht trupi gjykues, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave materiale, dëgjimit të mbrojtjes së të akuzuarve dhe pas vlerësimit të secilës provë një nga një dhe në lidhje reciproke me njëra tjetrën, komfor nenit 361 të KPP, vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara e të cilave gjykata ua fali besimin pa dyshim u vërtetua se i akuzuari I. D. kishte kryer veprat penale në bashkëkryerje, Kontrabandimi i mallrave nga neni 317 par.1 të KPRK-së lidhur me nenin 31 të KPRK-së si dhe veprën penale, Shmangia nga pagesat e tarifave doganore nga neni 318 par.1 të KPRK-së, ashtu që me datë 01.03.2016 rreth orës 10:01, në pikën e kalimit kufitar, në M., pas një marrëveshje paraprake e në bashkëkryerje nuk e kanë deklaruar mallin të cilin e kishin të ngarkuar në furgonin “VW Caddy” me regjistrim *numri i targave...*, të cilin e ka drejtuar i akuzuari I. D., ndërsa i akuzuari Q. B. me furgonin “Mercedes Vito 115”, me regjistrim *numri i targave...*, si dhe i akuzuari Sh. Xh. me furgonin “Mercedes” me regjistrim *numri i targave...*, mallin të cilin e kishin ngarkuar e të cilin mall e kanë kontrabanduar duke e sjellur nga Suedia për në Kosovë. Po ashtu i akuzuari I. D. me datë, kohë dhe vendin e njëjtë me qëllim

që mos të deklarojë mallin të cilin e kishin të ngarkuar në furgonin “VW Caddy” me regjistrim *numri i targave...*, për vlerën e mallit prej 1,311.50 euro, i njëjti i është shmangur pagesës së tarifave të detyrueshme doganore në vlerë prej 390.90 euro, të cilët duke vepruar në bashkëkryerje secili në mënyrën e vet kishte kontribuar në kryerjen e veprës penale.

Kjo gjendje faktike nuk është aspak kontestuese dhe gjetjen e tyre në ditën kritike në vendin e ngjarjes, pikërisht gjatë kalimit të tyre në pikën e kalimit kufitar në M., të cilën e vërtetuan me deklaratat e tyre edhe të akuzuarit nga te cilat deklarata u vërtetua se të akuzuarit nga Suedia kanë kontrabanduar mallin të cilin e kanë sjellur në Kosovë, ashtu që i akuzuari I. D. ka potencuar se i njëjti ka poseduar disa qanta, të cilat kanë pasur veshëmbathje të përdorura-të vjetëruara, ashtu që edhe të akuzuarit Xh. L. dhe L. H. gjatë mbrojtës së tyre kanë deklaruar se pasi që malli ka qenë i përdorur-i vjetëruar nuk i kanë detyruar që të paguajnë taksën doganore, duke theksuar se pasi që informatat nga sistemi kompjuterik kanë profilizuar rrezik të ulët dhe në bazë të atyre i kanë shikuar dhe kontrolluar mallin vetëm pjesërisht dhe i kanë liruar të tri veturat në mënyrë gojore duke iu thënë se jeni të liruar nga obligimet doganore, pa ndonjë formular, pasi që ekzistojnë formulalet të cilët duhet të plotësohen nga personat përgjegjës, në rastin konkret nga zyrtarët doganor për persona që lirohen nga doganimi i mallit, ashtu që duke mos deklaruar mallin të cilin e kishin me vete, të njëjtit i’u kanë shmangur pagesës së tarifave të detyrueshme doganore.

Nuk është kontestues fakti se të akuzuarit I. D., Sh. Xh. si dhe i akuzuari i cili gjendet në arrati Q. B., ditën kritike me dt.01.03.2016, kishin ardhur nga shteti i Suedisë dhe në Kosovë kanë hyrë përmes

pikë kufitare në M., kanë ardhur me tre furgonë si janë cekur edhe në dispozitivin e këtij aktgjykimi të cilët ishin të ngarkuar me mallra të ndryshme, siq u deklaruan me mallra të përdorura.

Po ashtu është fakt i pakontestueshëm se të njëjtit në Kosovë kanë hyrë përmes pikës doganore në M., kjo u vërtetua edhe nga mbrojtja e të akuzuarve Xh. L. dhe L. H. të cilët në ditën kritike ishin në detyrën e tyre prej zyrtarit doganor. Të akuzuarit kanë kaluar kufirin në mes të Serbisë dhe Kosovës në mënyrë krejtësisht ligjore e kjo u vërtetuar nga mbrojtja e të akuzuarit Xh. L. se ditën kritike ishte në detyrë së bashku me kolegun e tij L. dhe gjatë orarit të punës në orët e paradites kishin kaluar tre furgonë të cilët edhe i kishin futur në garazhin e doganës dhe i kanë kontrolluar por vetëm sipërfaqësisht e jo në detaje, ndërsa i akuzuari L., në shqyrtimin gjyqësor është mbrojtur në heshtje por gjatë deklarimit të tij në hetuesi i njëjti ka pranuar se ka qenë në detyrë dhe i kishin kontrolluar 3 kombi furgonë me mallra.

Është fakt i pakontestueshëm se i akuzuari I. kishte sjell nga Suedia, kjo binshëm është vërtetuar nga vendimi i gjykatës për sekuestrim kur nga i akuzuari janë marrë dhe sekuestruar mallra të shumta të vendosura në qanta, e po ashtu kjo u vërtetua edhe nga mbrojtja e të akuzuarit Xh. L. i cili është mbrojtur se kishte parë mallra të vjetra të përdorura të vendosura në qanta e që qantat mbanin një aromë të rëndë, dyshek e gjëra të ndryshme, po i akuzuari I. përveq sigurimeve për vetura nuk kishte paguar doganë për mallin e futur në Kosovë me arsyetimin se zyrtarët doganorë e kishin liruar nga obligimet doganore se kanë qenë mallra të vjetra.

Sa u përket të akuzuarve Xh. L. dhe L. H., po ashtu ishte fakt i pakontestueshëm se ditën kritike ishin në vendin e tyre të punës në pikën kufitare në M., se e kishin bërë kontrollimin e furgonëve dhe mallrave në të to dhe i kishin liruar pa paguar doganë, për shkak se mallrat ishin të përdorura, megjithatë i akuzuari Xh. edhe e pranoi se kontrollimin e mallit dhe të furgonëve nuk e kishin bërë në mënyrë të detajuar por vetëm pjesërisht dhe për atë mall nuk u kishin lëshuar kurfarë formulari që lirohen nga taksat doganore por vetëm në mënyrë verbale – gojore i kishin liruar të tre furgonet duke i cilësuar si mall i një rrezikshëmire të ulët dhe jo komerciale, por të njëjtit as nuk i ofruan gjykatës kurfarë dëshmie se sipas procedurave doganore mallat e përdorura apo te vjetruar janë të liruar nga taksat doganore, ngase edhe për mallrat e vjetra duhet të paguhet doganë por në përqindje me të ulët.

Mbrojtjes së të akuzuarve I. D. dhe Xh. L. gjykata nuk ua fali besimin, të cilët u munduan që me mbrojtjen e tyre ti ikin përgjegjësisë së tyre penale, se nuk kishin ndërmarr kurfarë veprime inkriminuese por që të gjitha veprimet e tyre ishin në përpuhshmëi më ligjin e kjo për faktin se i akuzuari I. kishte kontrabanduar mallra dhe atë nuk kishte paguar taksën doganore me arsyetimin se nuk i ishte kërkuar nga zyrtarët doganorë se mallrat ishin të vjetra, por veprat e tij ia kanë mundësuar me veprimet e tyre zyrtarët doganorë të cilët ua kishin mundësuar kalimin e tyre përmes kufirit me mos kontrollim të detajuar por vetëm sipërfaqësisht dhe vetëm gojarisht i kanë liruar pa e plotësuar formularin se janë të liruar nga taksat doganore.

Gjykata nuk arriti të vërtetojë se në veprimet e të akuzuarit I. D. përmbushën elementet e veprës penale Dhënia e ryshfetit siq edhe e ngarkon akuza në bashkëkryerje edhe me të akuzuarit Sh. Xh. dhe Q. B., kur janë pyetje një shume e caktuar dhe janë të përfshirë të tre të akuzuarit duke mos i ndarë veprimet konkrete të secilit të akuzuar dhe se cili i akuzuar sa të holla kishte dhënë, ndërsa nga të gjitha shkresat e lëndës, nga mbrojtja e të akuzuarve vetëm i akuzuari I. është deklaruar se ishte përgjegjës i mallit të sjell nga Suedia, dhe ai ishte personi i cili edhe kishte bërë pagesat e sigurimit, ndërsa për këtë vepër janë akuzuar pas dhënies se deklaratës apo rrëfimit siq është cekur në një pjesë të deklaratës së tij të akuzuarit L. H. i cili ka pranuar se I. D. u kishte dhënë të holla –ryshfet në shumë prej 650 € dhe të njëjtat edhe i kishte ndarë me të akuzuarin Xh.. Përveq deklaratës së të akuzuarit L., prokuroria e shtetit dështoi që edhe me prova te tjera ta vërtetojë këtë fakt, ngase i akuzuari më vonë nuk e ka pranuar se kishte pranuar ryshfet prej të akuzuarit I., ndërsa i njëjti gjatë shqyrtimit gjyqësor është mbrojtur në heshtje. I akuzuari I. nuk e pranoi se i kishte dhene ryshfet të akuzuarit L. e këtë nuk e pranoi as i akuzuari Xh., ato të holla nuk u gjetën tek të akuzuarit, nuk u vërtetua se e tërë ajo shumë që supozohej se u ishte dhënë sa ishin qindëshe apo në qfarë

kartëmonedhe ishin vlera e tyre ishte vetëm në total, nuk i kishte parë askush dhe nuk kishte as ndonjë fotografi apo qfarëdo dëshmie tjetër që do ta vërtetonte këtë fakt.

Po ashtu nuk u vërtetua edhe vepra penale marrja e ryshfetit ngase me asnjë provë nuk u vërtetuan elementet e kësaj vepre penale në veprimet e të akuzuarve Xh. L. dhe L. H., ndërsa Gjykata nuk mundi që vendimin e saj ta mbështetë vetëm në një provë e në rastin konkret vetëm në deklaratën e të akuzuarit L. i cili në një fazë të procedurës ka deklaruar se kishte pranuar ryshfet nga i akuzuari I. dhe ato të holla i kishin ndarë me të akuzuarin Xh..

Sa i përket të akuzuarit Sh. Xh. prokurori i shtetit dështoi të argumentoi me prova bindëse se i akuzuari Sh. ka kryer vepra penale siq e ngarkon aktakuza, e kjo për faktin se për veprën penale dhënia e ryshfetit edhe ky është përfshirë në bashkëkryerje me I. por që me asnjë prove të vetme nuk u vërtetua si edhe për veprat e tjera se cilat ishin veprimet inkriminuese që i kishte ndërmarrë, ndërsa gjykata ia fali besimin në tërësi mbrojtjes së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe po ashtu edhe të akuzuarve të tjerë në raport me të, e të cilët në mbrojtjën e tyre deklaruan se i akuzuari Sh. ishte vetëm bashkëudhëtar i të akuzuarit I. dhe qëllimi i tij ishte ardhja në Kosovë për ta vizituar nënën e sëmurë dhe se me vete kishte vetëm një qese me barna, e po ashtu të gjitha provat dhe dëshmitë vërtetuan se malli nuk ishte i tij po i vetmi veprim i tij ishte drejtimi i kombit disa metra para kufirit e deri në pikën doganore në M., gjë që e vërtetoi edhe vet i akuzuari Xh. se ishte i akuzuari Sh. që e kishte drejtuar kombin deri në garazhë dhe në pyetjen që ia kishte bërë se qfarë kishte në kombi i kishte treguar se nuk është pronari dhe nuk ishte përgjegjës, në ndërkohë që ishte paraqitur vet i akuzuari I. i cili ka pranuar se mallin e kishte sjell ai nga mërgimtarët shqiptar që jetojnë në Suedi.

Gjykata ia fali besimin mbrojtjes së tij të cilën edhe e cilësoi se reale dhe objektive dhe e njëjta edhe korrespondon edhe me mbrojtjen e të akuzuarve të tjerë se Sh. përveq barnave nuk kishte asgjë tjetër dhe ishte vetëm pasagjer i I., dhe se i njëjti ka pasur vetëm barna kjo nuk është aspak kontestues edhe për faktin se i njëjti edhe gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor dukshëm është vërejtur se ka probleme shëndetësore, andaj meqenëse i njëjti nuk ka transportuar kurrfarë malli, nuk ka pasur as obligime të taksave doganore.

Për të akuzuarin A. S., prokurori i shtetit po ashtu nuk arriti që të argumentoi me prova se i njëjti ka kryer veprat penale siq i vihen në barrë sipas aktakuzës, si dhe cilat ishin veprimet inkriminuese të tij, e që pas administrimit të provave dhe pas marrjes në pyetje të tij, gjykata vërtetoi se i njëjti ka jetuar në Kosovë, nuk e ka kaluar kufirin përmes doganës, nuk ka transportuar mallra e në mungesë të tyre edhe nuk ka pasur mundësi të bëjë pagesa doganore, apo siq edhe e ngarkon akuza shmangie nga pagesat e detyrueshme doganore, ngase ai vetëm është takuar me të akuzuarin I. D. në Podujevë, pasi i njëjti e ka kaluar kufirin dhe atë për ti marrë disa gjëra siq ishin një qantë, tri karriga të banakut, një mbulesë të shtratit të sjelluara përmes I. nga axha i tij i cili jetonte në Suedi. Gjykata ia fali besimin mbrojtjes së tij dhe e vlerësoi si reale dhe objektive si dhe në përputhshëmri edhe me të gjitha provat dhe dëshmitë e tjera.

Prokuroria nuk arriti që t'i argumentoj me fakte dhe prova para gjykatës elementet e veprës penale në bashkëkryerje, Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së për të akuzuarin I. D., dhe Sh. Xh. dhe për të akuzuarit Xh. L. dhe L. H. për shkak të veprës penale në bashkëkryerje, Marrje e ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të akuzuarin Sh. Xh. për shkak të veprës penale, Shmangia nga pagesat e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.1 të KPRK-së, dhe për të akuzuarin A. S., për shkak të veprës penale, Ndihma nga neni 388 të KPRK-së për kryerjen e veprave penale, Kontrabandimi i mallit nga neni 317 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale, Shmangia nga pagesat e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.1 të KPRK-së, me të cilat ngarkohen të akuzuarit ngase nga provat e administruara nuk gjeti se në veprimet e të akuzuarve formësohen elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprave penale, e që e përbëjnë figurën e veprave penale të cekura më lartë për të akuzuarit, për të cilat akuzoheshin, andaj nisur nga të gjitha këto që u thanë trupit gjykues pasi analizoi dhe vlerësoi provat e administruara dhe mbrojtjen e të akuzuarve, nuk gjeti se në veprimet e te akuzuarve formësohen elementet e veprave penale të lartcekura, dhe në mungesë të provave dhe mos ekzistimit

te elementeve të veprave penale, konform neni 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së, të akuzuarit për ato vepra penale i liroi nga akuza.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave të rëndësishme bazuar në faktet dhe provat e lartshënuara, konstatoi gjendjen faktike si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të akuzuarve janë konsumuar elementet e figurës së veprave penale, për të akuzuarin I. D. gjeti se në veprimet e tij manifestohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje, Kontrabandimi i mallrave nga neni 317 par.1 të KPRK-së lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale, Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.1 të KPRK-së, ngase bazuar në faktin se i akuzuari edhe përkundër faktit që mallin e bartur nga Suedia për në Kosovë, gjatë kalimit në pikën kufitare në M. nuk e ka deklaruar dhe me këtë rast me importimin e mallit të caktuar i është shmangur pagesës së tarifës së detyrueshme doganore, në veprimet e të akuzuarve Xh. L. dhe L.

H., gjykata gjeti se manifestohen elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ngase bazuar në faktin që përmes shfrytëzimit të kundërligjshëm të pozitës apo autorizimit me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie për vete apo për personin tjetër apo duke i shkaktuar dëm personit tjetër, në rastin konkret doganës së Kosovës ose që seriozisht të dy të akuzuarit i kanë shkelur detyrat që janë në kompetencë që si persona zyrtar t'i aplikojnë me rastin e zbatimit të detyrave përgjegjëse, ashtu që kontrollimin e mallit e kanë bërë vetëm pjesërisht duke mos e plotësuar formularin përkatës lidhur me mallin e kontrolluar, dhe të akuzuarit i kanë liruar nga pagesa e obligimeve doganore. Andaj, gjykata pasi që më parë gjeti se të akuzuarit janë penalisht përgjegjës, dhe se nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të tyre, të njëjtit i shpalli fajtor dhe u shqiptoi dënime të parapara ligjore të precizuara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi dhe bëri konfiskimin e sendeve të luajshme si mjete që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale apo mjete që ligjërisht duhet konfiskuar.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se: se i akuzuari I. D. ishte korrekt në gjykatë dhe me sjellje korrekte, mosha e tij, baba i tre fëmijëve, i pa punë, gjendjen e dobët ekonomike, për të akuzuarin Xh. L., mori parasysh sinqertitetin e tij deklarues, i martuar, baba i tre fëmijëve, ndërsa për të akuzuarin L. H. , mori parasysh se ishte korrekt në gjykatë dhe me sjellje korrekte, moshën e tij relativisht të re, i martuar, babë i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti dhe duke u nisur nga të gjitha këto gjykata me rastin e vendosjes lidhur me sanksionin penal ju shqiptoi dënimet si në dispozitiviet e këtij aktgjykimi, me bindje se këto dënime janë adekuate me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit , të paraparaë me nenin 41 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenin 73 par.2 të KPRK-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për llogaritjen e kohës së kaluar në masën e arrestit shtëpiak në dënimin me burgim është marrë në bazë të nenit 83 par.1 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin është marrë në bazë të nenit 62 par.1 dhe 2 nënpar.2.7, nenit 69, 317 par.5 dhe nenit 318 par.4 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 dhe 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

- Vetura i kthehet të akuzuarit A. S.si në diapozitivin e këtij aktgjykimi, ndërsa të gjitha gjësendet e sekuestruara me Aktvendimin e GJPP-së, PPRKR.nr.82/16 të datës 04.03.2016 konfiskohen, si mjete që janë përdorur në kryerjen e veprave penale .

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.191/16, datë 02.12.2016**

**Sekretarja juridike  
Nazife Sheholli**

**Kryetarja e trupit gjykues  
Valbona Musliu-Selimaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga data e marrjes së vendimit per Gjykatën e Apelit përmes kësaj gjykate.